



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-12744

Dt: 25.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve, Përfundimit 01 Nr. 06-9885-5/3 të miratuar në Mbledhjen Bordit të Drejtorëve me dt. 24.02.2016 me të cilin është miratuar kërkesa e Shoqatës Sindikale e Pensionisteve të Komunës së Gjakovës për mbulimin e shpenzimeve operative, me dt: 25.02.2016 e miraton këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës Sindikale të Pensionisteve të Komunës së Gjakovës e evidentuar me 01. Nr. 400-9894 e dt. 24.02.2016 për mbulimin e shpenzimeve operative, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1,500.00€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,500.00€ nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e Shoqatës Sindikale të Pensionisteve të Komunës së Gjakovës nr.1402000001782019 Banka Ekonomike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
  - Drejtësisë për Punë të Përgjithshme Administrative
  - Z. Esat Resyli, kryetar i Shoqatës Sindikale të Pensionisteve të Komunës së Gjakovës
  - Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila

